

Ekskluzive

Ekskluzive | Të shtënat në oborr i kushtojnë shtrenjtë 52-vjeçarit në Suharekë – Policia i sekuestron armën pas kthimit nga Gjermania



Sinjali.com

18 Korrik 2026 09:53



Një video-incizim, ku dyshohet se shihet një burrë duke shtënë me armë zjarri në oborrin e shtëpisë së tij, ka vënë në lëvizje Policinë në Suharekë, disa muaj pas ngjarjes, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se i dyshuari është **Murat Buzhala**, rreth 52-vjeçar.

Sipas burimeve të Sinjalit, të shtënat dyshohet se kanë ndodhur më 7 nëntor 2025, rreth orës 13:05, në fshatin Shirokë të Suharekës. I dyshuari dyshohet se kishte shtënë me pistoletë në oborrin e shtëpisë, ndonëse aty nuk po zhvillohej ndonjë aheng apo ngjarje tjetër familjare.

Po atë ditë, ai ishte larguar nga Kosova në drejtim të Gjermanisë, ku jeton dhe punon.

Hetuesit kanë siguruar më vonë një video-incizim të rastit, por i dyshuari ndodhej jashtë vendit. Më 17 korrik, Policia ka pranuar informacion se ai ishte kthyer në Kosovë dhe, në koordinim me Prokurorin e Shtetit, e ka shoqëruar në stacion për intervistim.

Gjatë procedurave, është sekuestruar një pistoletë Sarsilmaz, modeli B6, e kalibrit 9×19 mm, së bashku me një karikator. Arma dyshohet se është përdorur gjatë incidentit.

Ndonëse pistoletë ishte e pajisur me leje të vlefshme të lëshuar nga autoritetet e Kosovës, përdorimi i saj po hetohet veçmas.

Me urdhër të Prokurorit, rasti është iniciuar si “Përdorim i armës së zjarrit”, ndërsa i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt. Hetimet janë duke vazhduar.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

detaje ekskluzive

Gjermania

sekuestron

Suhareke

të shtëna armësh

Të tjera:




Franca dhe Gjermania kërkojnë forcimin e mbrojtjes së Evropës

Evropë



Rritet numri i të rinjve gjermanë që refuzojnë shërbimin ushtarak, ndërsa Berlini përpaket...

Evropë



Policia sekuestron më shumë se 1.2 ton kanabis në Portin e Hamburgut

Evropë



Gjermania në NATO: Nxënës model me shumë detyra

Evropë



Drama e penalltive eliminon Gjermaninë nga Kupa e Botës – çka zbuloi gazeta “BILD”

Futboll



Paraguai eliminon Gjermaninë nga Botërori pas penalltive

Futboll



Gjermania goditet nga temperatura rekord

Evropë



Manuel Neuer paralajmëron lamtumirën nga kombëtarja gjermane

Futboll

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhimë Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera